



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.12.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 04.11.2019, 12.11.2019, 13.11.2019, 21.11.2019, 02.12.2019, 03.12.2019, 04.12.2019 dhe 05.12.2019.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

11. Marçela Shehu

(anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 5. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 6. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 11. Erion Fejzulla, USAID.**
- 12. Valbona Bala, USAID.**
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.**

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 04.11.2019, 12.11.2019, 13.11.2019, 21.11.2019, 02.12.2019, 03.12.2019, 04.12.2019 dhe 05.12.2019.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 19.12.2019. Janë të pranishëm të gjithë anëtarët.

Siç jeni në dijeni nga rendi i ditës, sot kemi përfshirë në rendin e ditës 8 çështje. Ndërkohë që me propozim të dy anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht Zëvendëskryetari z. Maksim Qoku dhe zotit Medi Bici propozoj përfshirjen në rendin e ditës edhe të dy çështjeve të tjera, që janë: Ngritja e dy Komisioneve nga ana e Këshillit. Një Komision i cili do të jetë për hartimin e rregullave të brendshme të Këshillit dhe Komisioni tjetër i cili do të merret me çështjen e trajtimit të planit të veprimeve për backlogun në Gjykatën e Lartë.

Jemi dakord me përfshirjen në rend të ditës së këtyre dy çështjeve?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, vijojmë sipas rendit të ditës.

Çështja e parë e rendit të ditës është: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 4 nëntor, 12 nëntor, 13, 21, 2, 3 dhjetor, 4 dhjetor, 5 dhjetor.

Siç jeni vënë në dijeni nga administrata, procesverbalet ju janë përcjellë. Nga ana juaj nuk është shfaqur asnjë lloj diskutimi lidhur me përmbajtjen e procesverbaleve.

Atëherë, nëse nuk keni diskutime dhe qartësi apo paqartësi, ju ftoj për miratimin e procesverbaleve, miratimin e tyre.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

(Vota e zonjës Luli nuk dëgjohet.)

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 4 nëntor 2019, 12 nëntor 2019, 13 nëntor 2019, 21 nëntor 2019, 2 dhjetor 2019, 3 dhjetor 2019, 4 dhjetor 2019 dhe 5 dhjetor 2019.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vendim hy në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.12.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Vazhdimi i shqyrtimit të Raportit “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë” të përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, (për dy inspektore znj. {...} dhe znj. {...} – vijim nga mbledhja e datës 22.10.2019).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
5. *Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
6. *Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
11. *Erion Fejzulla, USAID.*
12. *Valbona Bala, USAID.*
13. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

2. Vazhdimi i shqyrtimit të Raportit “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë” të përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-

Këshillit të Lartë të Drejtësisë, (për dy inspektore znj. {...}dhe znj. {...} – vijim nga mbledhja e datës 22.10.2019).

Naureda Llagami: Kalojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës e cila ka të bëjë me: Vazhdimin e shqyrtimit të Raportit “Për vlerësimin e statusit individual për karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierës dhe konkretisht sot do merren në shqyrtim për dy inspektorët, për zonjën {...}dhe {...}, i cili është vijim nga mbledhja e datës 22 tetor 2019

Thjesht për t’ju sjellë në vëmendje, siç jeni në dijeni, në vijim të mbledhjes plenare të datës 22 tetor 2019, nga diskutimet dhe shqyrtimit të raportit për gjithsecilin, doli e nevojshme kryerja e disa verifikimeve të tjera dhe marrja e informacioneve lidhur me statusin e nëpunësit për dy inspektorët e ish-KLD-së. Nga ana e administratës së Këshillit i është kërkuar informacion Ministrisë së Drejtësisë, Departamentit të Administratës Publike si dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë Gjyqësor, lidhur me statusin e nëpunësit për të dy inspektorët.

Për më tepër informacion po ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Përkohshëm, zotit Medi Bici.

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Ashtu siç e vutë në dukje edhe ju, nga Ministria e Drejtësisë, nga Departamenti i Administratës Publike dhe nga administrata e Këshillit kanë ardhur përgjigjet për të dy inspektorët dhe kemi administruar shkresën nr. 6303/2 prot., datë 03.12.2019, e cila bën fjalë për zonjën {...}dhe thotë, pasi ka dhënë dorëheqjen, kjo dorëheqje rezulton të jetë miratuar nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 1769/1 prot., datë 21.09.2010 duke e liruar zonjën {...} nga shërbimi civil, dhe bashkë me dokumentat është pikërisht edhe kjo shkresë.

Gjithashtu, për inspektorën tjetër {...} ka ardhur përgjigja në Këshill dhe ndërmjet të tjerave kemi edhe vendimin nr.1, datë 08.05.2014, ku thuhet tek pika 1/f: “Zonja {...}, me detyrë specialiste juriste, kategori V (*lapsus, kategoria IV*), nëpunës civil i nivelit ekzekutiv”. Pra është nëpunëse civile e nivelin ekzekutiv.

Nëse doni ndonjë sqarim të mëtejshëm, meqenëse këto relacione i ka relatuar zonja/anëtarja Fatmira Luli, ia jap fjalën zonjës Fatmira në qoftë se ka ndonjë gjë për të shtuar.

Fatmira Luli: Unë do bëj vetëm një interpretim të shkurtër lidhur me përgjigjet e shkresave që kanë ardhur nga ministria dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Në momentin që janë emëruar të dyja këto zonja njëra në Ministrinë e Drejtësisë dhe tjetra në Gjykatën e Lartë (si ndihmëse), ka qenë përpara hyrjes në fuqi të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, nenit 28 të ligjit 9877/2008, i cili parashikonte afat për komandimin dhe procedurën e komandimit të gjyqtarëve në institucione të tjera si Ministria e Drejtësisë ose Gjykata e Lartë si ndihmës dhe këshilltarë.

Për të dyja këto zonja është vërtetuar me dokumentacionin që ishte protokolluar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kanë paraqitur kërkesa për t’u bërë gjyqtare brenda afateve që parashikon ligji, për t’u dhënë atyre mundësinë që të ktheheshin në sistemin gjyqësor. {...} ka paraqitur kërkesë pranë Këshillit të Lartë dhe {...} që në momentin e lirimt nga detyra e ndihmëses. Asnjëra prej tyre nuk ka punuar në një profesion privat. Është vërtetuar që {...} nuk ka qenë e regjistruar si avokate pranë QKB-së, po kështu edhe zonja {...}, nga dorëheqja që ka bërë në ministri në detyrën e inspektores pranë Ministrisë së Drejtësisë, ka ardhur ka punuar si inspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe në mënyrë të vazhdueshme ka paraqitur edhe brenda afateve ligjore kërkesa për t’u rikthyer në sistemin gjyqësor, kërkesa që nuk janë marrë parasysh nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe ato kanë vazhduar të punojnë në detyrën e inspektores.

Në këto kushte unë gjykoj që në përputhje me nenin 28 të ligjit 2008, paragrafin e fundit i cili i barazon edhe ato gjyqtarë që kanë punuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji në këto funksione në të cilën thuhet: Periudha e shërbimit të këtyre funksioneve të mësipërme, ku përfshihen edhe funksioni ku ka punuar zonja {...} dhe {...}, njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1, para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Dhe këto funksione janë cituar përsëri në ligj.

Në këto kushte, unë them që zonjat, pavarësisht se kanë fituar statusin e nëpunësit civil gjatë kohës që kanë punuar, nuk e kanë humbur statusin e gjyqtarit, prandaj duhet t'i deklarohet ky status nga kjo mbledhje e Këshillit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me sqarimet e dhëna dhe informacionin e marrë nga institucionet përkatëse?

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, do duhet të diskutojmë për rastin apo për informacionin?

Se s'po e kuptoj?!

Naureda Llagami: Atëherë, nëse nuk keni diskutime lidhur me atë që na janë vënë në dispozicion dhe çfarë referoi anëtarja e Komisionit, mund të kalojmë edhe në votim sipas propozimeve që kanë bërë. Nëse doni prapë kohë për të sqaruar...

Ilir Toska: Atëherë do desha të thosha diçka në lidhje me të dy inspektoret sa i përket pasjes ose jo të statusit. Është evidentuar në të dyja rastet se kanë dhënë dorëheqjen, se kanë qenë në pozicionin e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë në Gramsh (zonja {...}) dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër (për zonjën {...}). Në fakt, ngërçi i dhënies së dorëheqjes sepse ato janë, pas kësaj dorëheqjeje që është miratuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë shkuar në një pozicion, që sipas ligjit aktual në fuqi (ligji për Statusin) është një pozicion në institucionet e sistemit të drejtësisë. Ngërçi ka qenë se, Kushtetuta e kohës, pra Kushtetuta e miratuar në vitin '98, në nenin 143 e ndalonte çdo veprimtari tjetër shtetërore, politike, private për gjyqtarin. Për të zgjidhur këtë ngërç, ndërsa ligji lejonte të vinte në një institucion të sistemit të drejtësisë, gjithmonë është operuar në dhënien e dorëheqjes nga gjyqtarët dhe kanë vijuar ushtrimin e pozicionit në një institucion të sistemit të drejtësisë. Kjo ka ndodhur edhe me dy inspektoret në fjalë. Fakti që në pozicionin që ka marrë në Ministrinë e Drejtësisë apo në pozicionin që ka marrë në Gjykatën e Lartë zonja {...}, kurse zonja {...} në Ministrinë e Drejtësisë (që ka qenë me status), referuar ligjit të institucioneve të tyre, pasja e statusit civil ka qenë një obligim por asnjëra nga ato nuk ka konkurruar për të marrë statusin e nëpunësit civil.

Ligji për Ministrinë e Drejtësisë ka garantuar një pozicion për çdo gjyqtar që konkurronte dhe jepte Këshilli pëlqimin. Këtë e ka bërë edhe ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” në vitin 2008.

Ndërkohë që sa i përket zonjës {...}, mbasi ka mbaruar ushtrimin e funksionit të ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë, ka disa kërkesa për t’u rikthyer në sistem. Organi i emërtesës (Këshilli i Lartë i Drejtësisë) nuk ka konsideruar asnjë prej tyre por ka konsideruar ta punësojë pranë vetes, pra në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në pozicionin e specialistet. Fakti që ka qenë në pozicionin e specialistet dhe do duhet të përfitonte pagën sipas pozicionit që kryente dhe është kategorizuar, nuk do të thotë që ka humbur statusin, sa kohë organi i emërtesës nuk i ka rikthyer në sistem sipas kërkesave që ato kanë paraqitur.

Ky është mendimi im sa i përket pasjes ose jo të statusit dhe mendoj se të dyja inspektoret, qoftë zonja {...}, qoftë zonja {...} e kanë statusin e magjistratit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë diskutim tjetër?

Atëherë, propozimi i Komisionit është që për të dy zonjat...

Dy propozime. Propozimi i parë...

Fatmira Luli: Propozimi i parë “pasje”. Maksi është me “mospasje”. Unë me Mediun jemi me “pasjen” e statusit.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë fillimisht propozimin e shumicës nga ana e Komisionit. Pra, propozimi i parë është që të deklarojë pasjen e statusit magjistrat për zonjën {...}. Zonja {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë?

Brikena Ukperaj: Atëherë, nuk e mora fjalën më parë sepse jam dakord me qëndrimin, me sa u parashtrua nga zonja Luli dhe zoti Toska lidhur me statusin e magjistratit për zonjën {...} {...} dhe zonjën {...} {...}, për shkak sepse vlerësoj që neglizhenca e organit ose mos shprehja e organit për t’i emëruar, ndërkohë që të dyja, si zonja {...} dhe zonja {...} kanë bërë kërkesë për t’u rikthyer në sistemin gjyqësor, nuk

mund të përbëjë shkak për humbjen e statusit të gjyqtarit, -e para. Ndërsa, jam dakord me deklarin e pasjes së statusit të magjistratit për të dyja zonjat. Për pjesën e dytë do të kisha mendimin që ato do të vijojnë komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit derisa Këshilli të shprehet me një vendimmarrje tjetër, siç kemi operuar edhe për gjyqtarët e tjerë që i kemi konfirmuar statusin ose kemi deklaruar pasjen e statusit, për arsye sepse të dyja zonjat nuk kanë... janë marrë me inspektive, që të pritët ose të vijojë komandimi deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për këtë arsye do të propozoj që pika 2 të riformulohet, duke thënë që zonja {...}, t'i vijojë komandimi në detyrën e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në një vendimmarrje tjetër të Këshillit. Ky është propozimi.

Naureda Llagami: Ta kalojmë në votim projekt-aktin me gjithë propozimin e bërë nga zonja Ukperaj?

Atëherë kalojmë projekt-aktin për votim.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro. Me arsyetim tjetër, të cilin e kam bërë në seancën e datës 22.10.2019.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të deklarojë pasjen e statusin “Magjistrat” për znj. {...}. Znj. {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin pranë Njësisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve deri në një vendimmarrje

tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-propozimi tjetër që bëhet fjalë për zonjën {...}. Atëherë, jeni dakord që edhe në këtë projekt-propozim të mbajmë të njëjtin standard?

Po! Pra ta hedhim në votim së bashku me propozimin e bërë nga, amendimin e bërë nga zonja Ukperaj. E hedhim në votim projekt-aktin me gjithë propozimin e zonjës Ukperaj.

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro. Me arsyetim tjetër, të cilin e kam bërë në mbledhjen e datës 22.10.2019.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Të deklarojë pasjen e statusin “Magjistrat” për znj. {...}. Znj. {...} të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin pranë Njësisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve deri në një vendimmarrje tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.12.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për “Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, bashkëpropozim i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)

9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
5. *Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
6. *Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
7. *Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
8. *Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
9. *Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
10. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
11. *Erion Fejzulla, USAID.*
12. *Valbona Bala, USAID.*
13. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit për “Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe

procedurën e komandimit”, bashkëpropozim i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës dhe Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë në çështjen tjetër të radhës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, projekt-akt i cili vjen si bashkëpropozim i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do të relatohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Atëherë, ky projektvendim vjen si domosdoshmëri për të pasur në njësinë e këshilltarëve ligjorë në strukturën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, kontributin e një stafi të kualifikuar dhe me eksperiencë në fushën e gjyqësorit. Aktualisht Këshilli ka të komanduar në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve dy gjyqtarë. Në këtë njësi janë 8 Këshilltarë Ligjorë, 3 prej të cilëve mbështesin aktualisht Komisionin për Zhvillimin e Karrierës, 2 Komisionin e Vlerësimit Etik dhe Profesional dhe 2 të tjerë Komisionin e Disiplinës.

Plotësimi i Njësisë së Këshilltarëve Ligjorë është nevojë imediate për punën e Komisioneve, prandaj komisionet iniciues të këtij projektvendimi, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të ligjit 115/2016, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i propozojnë mbledhjes plenare që të shpallë përsëri kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e 1 (një) pozicioni vakant “këshilltar ligjor” në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Në këtë vendim, sikundër edhe në vendimin e mëparshëm rregullohet shpallja e kërkesës për plotësimin e pozicionit, kohëzgjatja e shpalljes, kriteret e vendosura dhe procedura e komandimit në këtë pozicion.

Vendimi është i njëjtë si ai që kemi miratuar më parë për plotësimin e dy pozicioneve për “këshilltar ligjor” dhe për “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Në vendim janë të parashikuara, përveç procedurës se si bëhet shpallja e kërkesës për kandidatura, dokumentacioni që duhet të paraqesë kandidati, kohëzgjatjen dhe kriteret e procedurës së komandimit deri në 2 vjet me të drejtë ripërsëritjeje. Gjithashtu janë parashikuar edhe kushtet kur ky komandim mund të ndërpritet: kur vetë gjyqtari, për shkaqe të justifikuara, kur vetë gjyqtari mund ta kërkojë ose për shkaqe të tjera të justifikuara vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.

Janë përcaktuar kriteret e komandimit, si eksperiencia në punë jo më pak se 3 vjet; komandimi të mos bjerë ndesh me interesat e gjykatës; të mos jetë kandidati në një pozicion me mandat të kufizuar; të mos jetë i komanduar; ai që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së komandimit; si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Janë të përcaktuara dhe kriteret e përparësisë në rastet e më shumë se një kandidati. Është përcaktuar në vendim dokumentacioni mbi bazën e të cilit do të bëhet vlerësimi, procedura që ndiqet, e cila vijon me shpalljen e kërkesës, paraqitjen e kërkesave, dokumentacionin, vijimi i përgatitjes së opinionit nga ana e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës dhe më pas vlerësimi që do i bëjë Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale të gjithë kandidatëve të kualifikuar për renditjen e tyre, referuar kritereve të përparësisë.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 11 të vendimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të vendosë komandimin e gjyqtarit kandidat të propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Gjithashtu në këtë pikë përcaktohet se në rast të mosmiratimit të këtij propozimi, çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të propozojë komandimin e një gjyqtari tjetër që plotëson kriteret e komandimit dhe ky propozim i nënshtrohet votimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë në pikën e fundit të vendimit rregullohet situata ligjore kur asnjë prej gjyqtarëve kandidatë nuk komandohet. Në këtë rast Këshilli ka diskrecion si vetë organi që zhvillon procedurën por edhe organi që nevojshëmërinë për komandimin e gjyqtarit të rishpallë ose jo kërkesën për plotësimin e vendit vakant.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me pjesën e aktit të propozuar, ndonjë koment, sqarim?

Atëherë, e kalojmë aktin sipas propozimit të bërë nga të dy Komisionet?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, sipas propozimit të bërë nga të dy Komisionet.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.12.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Raportimi mbi informacionin e Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën korrik - shtator 2019, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 5. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Erion Fejzulla, USAID.*
- 12. Valbona Bala, USAID.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

4. Raportimi mbi informacionin e Kryetarëve të Gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën korrik - shtator 2019, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me raportin mbi informacionin e kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën korrik - shtator 2019. Edhe ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do të relatohet në mbledhjen e Këshillit nga zonja Brunilda Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Atëherë, siç janë njohur të gjithë anëtarët me këto të dhëna, të përcjella nëpërmjet e-mailit, nga memo-ja që është përgatitur nga këshilltarja, znj. Alsma Shehu dhe një raportim duke nxjerrë problematikat dhe propozimet për zgjidhje nga ana e Komisionit. Ndoshta nuk ia vlen që të lexohet fjalë për fjalë sepse ju e njihni dhe ka statistika. Unë thjesht, mbase do ndalon në disa pika për të tërhequr vëmendjen dhe ndoshta se do ketë nevojë për diskutim.

Pak a shumë të dhënat janë të ngjashme me ato që kanë ardhur edhe tremujorët paraardhës. Ndoshta tremujorin e fundit mund të bëhet një analizë më sinjifikative për të bërë ndoshta një analizë njëvjeçare edhe për të pasur dhe ide më të qarta se çfarë ndodhi gjatë këtij viti edhe nën një administrim të ri, le të themi, të gjyqësorit nga Këshilli.

Atëherë, thjesht, disa momente që doja të ndalesha ishte në lidhje me informacionin që jepet nga gjykatat për ngarkesën e çështjeve gjyqësore. Siç mund t'ju kërkohet nga raportimi i mëparshëm, pjesa më e madhe e gjykatave i përcillnin statistikat gabim. Ndërkohë që këtë tremujor është një përmirësim i ndjeshëm. Të gjitha pothuajse i kanë sjellë statistikat korrekte, me disa probleme të vogla që besojmë do korrigjohen në vitin pasardhës. Ndoshta edhe me miratimin së shpejti nga ana e Këshillit të tabelave statistikore dhe ato që do të plotësohen në funksion të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Tremujorin e parë u propozua nga Komisioni jonë që ndoshta do kishte nevojë për një trajnim të kancelarëve, për mënyrën se si përpilohen statistikat. Ndërkohë nuk është realizuar një trajnim i tillë. Por nga Komisioni vlerësohet që nuk është i nevojshëm.

Është sugjeruar dhe unifikimi i mënyrës së regjistrimit manualisht të çështjeve duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e gjykatave kanë sistemin që i themi shkurt

ICMIS dhe tashmë të gjithë i dimë problemet që sjellë ai sistem dhe gjëja kryesore është mosgjenerimi i statistikave dhe pothuajse të gjitha gjykatat këto i bëjnë manualisht. Kështu që do kishte nevojë për një unifikim, por edhe kjo mbase do zgjidhet me tabela statistikore të miratuara nga Këshilli, në funksion të procesit të vlerësimit etik dhe profesional.

Nga statistikave që sjellin, disa momente do veçoja, për shembull Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka një rritje të konsiderueshme të ngarkesës me tremujorin e parë. 149 çështje mesatare për gjyqtar, nga 128 që ka pasur. Është ajo e rrethit gjyqësor Elbasan e cila këtë tremujor raporton 168 çështje mesatare për gjyqtar, nga 115 të tremujorit të parë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka një ngarkesë mesatare për gjyqtar ndjeshëm ndryshe nga gjykatat e tjera, është 195 çështje për gjyqtarët e dhomës civile, 76 për ato të penales. Ndërkohë që tremujori i parë ka qenë 104, por ka qenë në total, jo e ndarë sipas dhomave.

Doja të ndalesha tek Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, që të gjithë e dimë situatën aty. Është vetëm 1 gjyqtar gjatë kësaj periudhe raportimi. Ka një numër total të çështjeve të pagjykuara 1057, nga të cilat 245 janë ende të pashortuara, 413 janë në shqyrtim nga gjyqtari {...} dhe 399 të tjerë janë në mënyrë të pashpjegueshme, figurojnë në statistika në shqyrtim nga gjyqtarja {...}, tashmë e pezulluar nga detyra, që në fillim të kësaj periudhe raportimi (është data 04.07.2019, me vendimin nr. 175 të KPK-së). Se ndoshta nuk e theksova në raportim, bëhet fjalë për periudhën korrik-shtator 2019.

Kështu që, nuk e di, ndoshta duhet t'i kërkohej një sqarim kryetarit në detyrë për këtë situatë që... është komunikuar nëpërmjet telefonit me kancelarin por nuk është se është dhënë ndonjë shpjegim.

Ajo që ngelet përsëri problematike është Gjykata e Apelit Tiranë, që ka një ngarkesë 481 çështje për gjyqtar relator nga 400 që raportonte në tremujorin paraardhës. Është një ngritje goxha e madhe, e ndjeshme.

Dhe për Gjykatën e Apelit Administrativ e cila siç e dimë ka backlog dhe një diferencë të madhe midis gjyqtarëve. Në fakt më tepër diferenca është tek backlog-u se sa

numri i çështjeve që ata shqyrtojnë në periudhë korente. Domethënë brenda vitit, brenda tremujorëve nuk ka diferencë në shqyrtimin e çështjeve nga një gjyqtar tek tjetri, por ka tek backlog-u.

Po kështu edhe Gjykata e Lartë, nga 32 106 që kishte tremujorin e parë, sot numëron 33 775 çështje.

Pastaj këto problematikat e tjera të përgjithshme janë si tremujorin e parë. I keni tek raportit.

Për çështjet e zvarritura tej afateve të arsyeshme është pothuajse e njëjta situatë. Është problematike edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Apeli Administrativ Tiranë dhe administrativja e shkallës së parë Durrës. Edhe arsytet e zvarritjeve janë ato që kanë qenë edhe tremujorin e kaluar.

Për etikën dhe solemnitetin nuk raportohen problematika.

Për situatën e kërkesave për heqje dorë të miratuara nga kryetari, është e njëjta situatë si edhe herën e kaluar. Është problemi teknik i sistemit që përdorin këto gjykata, të cilat nuk bëjnë automatikisht përjashtimin e gjyqtarëve të hetimit paraprak nga atyre të fazave të tjera dhe bëhen dorëheqjet e detyruara. Ndërkohë që ajo që është për t'u theksuar është që jo të gjitha gjykatat e kanë këtë problem sepse një pjesë e kanë zgjidhur me urdhër, duke i përjashtuar paraprakisht këta gjyqtarë nga shorti sepse krijon një situatë artificiale, duket sikur ka probleme me heqjet dorë, ndërkohë që shkak kryesor është ky.

Për regjistrimin e sistemit audio dhe nivelin e përdorimit nga secili gjyqtar, është e njëjta situatë pothuajse si tremujorin e kaluar.

Po kështu edhe për sistemin ICMIS dhe problematikat e tjera që janë sipas pikës /g/ të vendimit nr.25, të cilat në mënyrë të detajuar i keni tek raportimi dhe tek tabelat e statistikave.

Nëse keni ndonjë pyetje a paqartësi?!

Ky ishte në mënyrë të përmbledhur raportimi.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, raportimi është për periudhën korrik-shtator, pra për një periudhë tremujore. Në fakt tabelat flasin për një periudhë 9-mujore. Do duhet ta konsideroni, të raportoni. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Ndoshta në moment të parë ashtu duket, por ka të bëjë vetëm të dhënën që lidhet me regjistrimin e çështjeve, që e kemi sqaruar. Sepse këto tabelat e deklarimit të këtyre informacioneve janë tip dhe ne i kemi miratuar me vendim dhe për të pasur të qartë ngarkesën momentale të gjyqtarit apo gjykatës, gjithmonë referimi bëhet nga regjistrimi i çështjeve në 1 janar. Sepse në qoftë se do ta kërkonim regjistrimin pastaj, për shembull nga 1 marsi, nga 1 korriku, ishte çorientuese si informacion dhe nuk është se nxirrje ndonjë konkluzion.

(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Jo! Numri i çështjeve të gjykuara është për totalin. Është për 9 muaj. I bie që për këtë radhë është për 9 muaj.

Pyetja ishte: - Si mund ta identifikojmë sa ka gjykuar për 3 muaj?

Ajo e bëshme është sepse bën diferencën me tabelat e tremujorit të parë.

Nëse ju e kërkon si informacion këtë...

(Zoti Toska flet pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Toska: Ngaqë raportimi ishte për 3 muaj... janë për 9 muaj.

Okej! Ke të drejtë për këtë. Por tek shpjegimi dhe tek raportimi përmbledhës, për secilën gjykatë është bërë shpjegimi, duke thënë që diferenca me tremujorin e parë është kjo. Dhe tek momentet ku u ndalova, tek gjykatat që ishin më problematike (dhe e lexova dhe e theksova), pra në tremujorin e kaluar, për shembull Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan apo ajo e apelit Tiranë, gjithmonë referimi/krahasimi ishte me tremujorin e parë dhe kjo analizë është bërë duke krahasuar tabelat e tremujorit të parë me këtë të fundit. Domethënë nga tabela nuk del automatikisht. Kjo del tek analiza (i dyti me të tretin ose i dyti me të parin).

U theksua që në fillim që statistikën e tremujorit të parë erdhën pothuajse të gjitha me probleme. Me insistimin dhe komunikimin që është bërë nga ana e Këshillit me kancelarët dhe kryesekretarët, një pjesë e mirë e tyre u ridërguan, por në këtë tremujor

janë pothuajse të gjitha të sakta. Kështu që krahasimi me tremujorin e mëparshëm e ka këtë element vështirësie të krahasimit për shkak të cilësisë së statistikave. Por që mendojmë që tremujori i fundit që do jetë edhe përmbledhës për vitin, do jetë një tablo më e qartë edhe për ne, për të kuptuar çfarë është duke ndodhur me ecurinë, sidomos të ngarkesës që mendoj që është elementi kryesor i këtij informacioni.

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit zonja Kadi!

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Përdorimi i sistemit audio në Gjykatën e Rrethit Tiranë është shumë i ulët. Nuk e di?! A del shkakut aty, pse?

Brunilda Kadi: Kjo, siç unë e thashë në pjesën më të madhe të raportimit është e njëjta situatë me tremujorët e tjerë dhe që do të thotë që shkakut është i njëjtë. Besoj është e ditur për të gjithë ne fakti që Gjykata e Tiranës ka numrin më të madh të gjyqtarëve dhe ka numrin më të vogël të sallave në dispozicion të gjyqtarëve. Është kjo arsyeja kryesore. Mund të ketë brenda këtyre statistikave, domethënë edhe ndonjë arsye subjektive, personale ose jomenaxhim i duhur nga ana e gjyqtarëve të caktuar, por kjo ne nuk na del nga të dhënat që kërkojmë. Nëse ju mendoni që duhet kërkuar ky informacion më në detaj për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mund ta kërkojmë, që nëse ka gjyqtarë që pavarësisht se kanë salla në dispozicion, nuk i përdorin, të shikohet...

Alban Toro: Besoj për vlerësimin është i domosdoshëm ky informacion, ma do mendja mua, për të ardhmen.

Brunilda Kadi: Ky informacion, domethënë bruto si informacion, ai gjendet në çdo kohë që ta kërkojmë në gjykatë. Thjesht nuk na është, - si të themi, -filtruar ne sepse nuk e kemi kërkuar në mënyrë të detajuar për çdo gjyqtar. Ajo vjen me përqindje, sepse kështu është miratuar formulari. Keni parasysh edhe vështirësinë për t'u sjellë. Por nëse ju e vlerësoni që mund të kërkojmë edhe në mënyrë specifike kjo, e diskutojmë.

Alban Toro: Po shkakut i dorëheqjeve, se shikoj që ka një numër të madh dorëheqjesh të gjyqtarëve gjatë gjykimit, shkakut rezulton të jetë...

Brunilda Kadi: Një pjesë e gjykatave e sjellin informacionin dhe unë e theksova, tek ato gjykata që ka një numër ndjeshëm të madh në krahasim me të tjerat, vinte për

shkak të problemit teknik të sistemit, dhe thashë që ka të bëjë me çështjet penale më shumë, dorëheqjet. Pra gjyqtari i hetimit paraprak, kur hidhet shorti për fazën e dytë apo të tretë ai përfshihet, e përfshin sistemi automatikisht, se nuk e përjashton dhe ai detyrohet që kur i bie çështja, të kërkojë dorëheqjen. Se s'ka mjet tjetër procedural që ai të heqë dosjen nga shqyrtimi. Ndërkohë që, unë di për shembull nga gjykata nga e cila vij, është e zgjidhur (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë), di që bëhet manualisht përjashtimi i (në mos qofsha e gabuar, se unë nuk kam gjykuar penale), por edhe te civilja, kur hidheshe shorti, gjyqtarët e përjashtuar ose që kishin pengesë në gjykim, përjashtoheshin manualisht tek shorti dhe nuk krijoheshin këto situata artificiale, që duket sikur ka probleme me mosgjykimin e çështjeve për arsye subjektive. Pra pjesa dërrmuese e kësaj statistike, vjen për këtë shkak. Pastaj të tjerat, nuk raportohen çështje, se në fakt ne tek vendimi kemi kërkuar dorëheqje për konflikt interesi. Nuk është raportuar në mënyrë specifike.

Alban Toro: E fundit.

Tek Gjykata e Apelit Shkodër më rezulton që nuk ka çështje tej afateve.

Jo më larg, por para dy javësh, kam një informacion për ta trajtuar brenda Komisionit tonë, dhe më rezulton që një gjyqtare ka bërë...

(Zonja Kadi dhe zonja Ukperaj flasin pa ndezur mikrofonat.)

Atëherë, është faqja 13, 15.

(Zonja Ukperaj flet pa ndezur mikrofonin duke sqaruar mbi afatet e çështjeve.)

Alban Toro: Okej!

Naureda Llagami: Nëse kemi mbaruar diskutimet lidhur me raportin, siç kemi vepruar edhe herën tjetër, ne thjesht kalojmë në parim votimin e raportit/informacionit të përcjellë nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale.

Atëherë, kalojmë parimisht?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

(Vota e zotit Toro nuk dëgjohet.)

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.12.2019)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e tabelave standarde me të dhënat statistikore të nevojshme, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 5. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 6. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 9. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 11. Erion Fejzulla, USAID.*
- 12. Valbona Bala, USAID.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e tabelave standarde me të dhënat statistikore të nevojshme, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me projektvendimin lidhur me miratimin e tabelave standarde me të dhënat statistikore të nevojshme, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, i përgatitur edhe ky projekt-akt nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Për më shumë sqarime, fjalën po ia jap kryetares së këtij Komisioni, zonjës Brikena Ukperaj.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Kryetare!

Brikena Ukperaj: Sikundër jeni në dijeni, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale është ende në procese të hartimit të drafteve për të plotësuar skemën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, e cila nuk është vetëm ajo çka parashikon ligji por edhe një tërësi aktesh nënligjore që duhet të nxjerrë Këshilli. Në këtë kuadër, për shkak të domosdoshmërisë që ka në këtë moment miratimi i tabelave standarde me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit, Komisioni po ju sjellë sot për miratim në mbledhje plenare, pikërisht formën tabelare, se si të dhënat statistikore të gjykatave do të plotësohen për qëllime të vlerësimit etik dhe profesional.

Nevojshmëria dhe domosdoshmëria e miratimit në këtë moment të këtyre tabelave është edhe për një shkak tjetër sepse referuar akteve nënligjore që ne kemi miratuar “Metodologjisë” dhe “Rregullave plotësuese për vlerësimin e gjyqtarëve”, brenda muajit janar të çdo viti, kancelarët dhe kryetarët e gjykatave duhet t’i përcjellin Këshillin të Lartë Gjyqësor të dhënat statistikore të nevojshme për vlerësimin.

Në fakt, nuk është se tabela është një shpikje që po e bëjmë ne sot. Tabelat standarde statistikore kanë ekzistuar që në momentin kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ish-Inspektorati që ka funksionuar pranë këtij Këshilli ka miratuar tabelat për efekt të vlerësimit etik dhe profesional. Këto tabela thjesht janë përmirësuar dhe janë plotësuar me të gjitha elementët e nevojshëm që duhen për të krijuar bazën e mjaftueshme për vlerësimin etik dhe profesional. Janë shtuar disa rubrika. Disa rubrika të tjera janë hequr.

Tabelat standarde janë hartuar duke iu referuar llojit të gjykatës, sipas kompetencës lëndore dhe nivelit të gjykatës (pra gjykatë e shkallës së parë apo gjykatë e

apelit) të dhënave të vlerësimit të përcaktuar në ligj dhe; të dhëna të tjera të vlerësimit që vetë Këshilli ka përcaktuar si të nevojshme me aktet që ka miratuar deri në këtë moment.

Mbi këtë bazë janë hartuar tabela me të dhëna statistikore për gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit të juridiksionit të përgjithshëm; për gjykatat administrative të shkallës së parë dhe të apelit dhe për gjykatën për krimet e rënda (në të ardhmen Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – shkalla e parë dhe apelit).

Tërheqin vëmendjen që në tabelat që i referohen gjykatës së shkallës së parë për krimet e rënda ose gjykatë e posaçme është përdorur e njëjta terminologji, për shkak se periudha e vlerësimit 2017-2019 do bëhet për gjyqtarët e gjykatës për krimet e rënda, ndërkohë që duke qenë se tabelat kanë jetëgjatësi, pra bëhen sot për të ardhmen, është parashikuar edhe natyra e çështjeve që do ketë gjykata e posaçme në të ardhmen në kompetencën e saj lëndore. Për këtë arsye, në tabela i gjeni të dyja emërtimet.

Lidhur me tabelat statistikore për Gjykatën e Lartë, ato nuk janë pjesë e këtij projektvendimi, pasi është vlerësuar që të miratohen në një moment të mëvonshëm, për shkak të nevojës për përpunimin e tyre, duke iu referuar edhe specifikave të gjykimit në këtë gjykatë. Është hera e parë që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë janë subjekt i vlerësimit etik dhe profesional, por në kushtet kur asnjë prej tyre nuk i nënshtrohet programit të vlerësimit për vitin 2020, miratimi i tabelave standarde me të dhëna statistikore për veprimtarinë e tyre nuk përbën dhe çështje emergjente të Këshillit, por është një çështje që do të trajtohet në vazhdimësi.

Si janë të ndërtuara këto tabela. Për sa i përket përmbajtjes së tabelave, të dhënat statistikore janë përcaktuar duke iu referuar parashikimeve nënligjore dhe nevojave specifike të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Së pari, të dhënat e kërkuara nga ligji sipas përcaktimeve të nenit 90 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr.96/2016, në të cilin parashikohen si të dhëna të domosdoshme për vlerësim, por jo shteruese (pra ligji i lejon organet që të miratojnë edhe të dhëna të tjera), të dhënat e mëposhtme:

- numri i çështjeve të gjykuara në cilësinë e relatorit ose anëtarit;

- numri i çështjeve të gjykuara nga gjyqtari në një gjykatë tjetër (pra si gjyqtar i transferuar përkohësisht ose i caktuar përkohësisht);
- kategorizimin çështjeve sipas natyrës së tyre;
- kohën e gjykimit krahasuar në raport me afatet ligjore ose standardin minimal të kohëzgjatjes së gjykimit;
- numrin e seancave gjyqësore për çdo çështje;
- rendimentin e gjyqtarit;
- kohën për arsyetimin e vendimit;
- numrin e çështjeve në të cilat gjyqtari është përjashtuar me kërkesë të palëve; numrin e kërkesave për heqje dorë të pranuar, në referim të nenit 90 shkronja “d” të ligjit nr.96/2016 dhe metodologjisë së pikëzimit, e cila e përcakton “numrin tejet të lartë të kërkesave të pranuar për përjashtim” si një ndër treguesit e vlerësimit të paanësisë së gjyqtarit.

Lidhur me të dhënat shtesë të përcaktuara nga Këshilli në këto tabela, në referim të nenit 90 shkronja b, pika e tretë e ligjit 96/2016, të dhëna të përcaktuara në metodologjinë e miratuar. Të dhënat shtesë janë si më poshtë:

-Është numri i seancave të zhvilluara në sistem audio, të cilat kërkohen për efekt të vlerësimit të aftësive organizative të gjyqtarit (numri i seancave është i evidentuar në tabela, do t’i shikoni, për të gjithë çështjet, jo në tërësi pra, nuk vjen si një e dhënë bllok për të gjitha gjykimet por vjen në mënyrë të specifikuar në tabele për secilën çështje). Nuk është e shkruar në relacion por po ju tërheq vëmendjen që, kjo e dhënë, nga Këshilli mund të përdoret vetëm në rastet kur sistemi i menaxhimit të çështjeve e gjeneron në mënyrë automatike. Në rregullore, por edhe referuar ligjit, kemi parashikuar që nëse kjo e dhënë nuk gjenerohet në mënyrë automatike, për sa i përket përdorimit të sistemit audio do t’i referohemi çështjeve ose dosjeve të përzgjedhura për short. Megjithatë, në dijeninë time, sot të gjitha gjykatat e gjenerojnë në mënyrë automatike se sa është përqindja audio e seancave gjyqësore që regjistron çdo gjyqtar (atje ku përdoret sistemi, sigurisht).

Së dyti, kohën e gjykimit krahasuar me afatin ligjor të gjykimit, në rastin e çështjeve për të cilat ligji parashikon afat shqyrtimi. Në relacion, duke marrë parasysh që

ky relacion është bërë në formën edhe të një metodologjie orientuese për mënyrën se si do të plotësohen tabelat, janë dhënë disa shembuj, nuk po i lexoj sepse janë thjesht përmendje të ligjit për çështje të caktuara që vetë ligji parashikon afate ligjore gjykimi.

E dhënë tjetër e përcaktuar nga Këshilli ose që e propozon Komisioni për të qenë element i tabelës, është data e nxjerrjes së çështjes për short për gjykim për çështjet në gjykatën e apelit, në referim të nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale, nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile dhe vendimit nr. 78 të datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Jemi në dijeni që për gjykatën e apelit gjykimi i çështjeve nuk ndjek të njëjtin rit si ai i gjykimit në shkallë të parë, pra nuk fillon në të njëjtin moment gjykimi i të gjitha çështjeve. Gjykata e apelit, sigurisht që ndjek respektimin e afateve ligjore, çështje për të cilat në Kodin e Procedurës parashikojnë afate gjykimi, ndërkohë që për çështje të tjera ndjek kalendarin e shqyrtimit të çështjeve dhe sidomos respekton dhe nenin 399 e vijues të Kodit të Procedurës Civile për gjykimin e çështjeve jo tej afatit të arsyeshëm.

Një e dhënë tjetër e rëndësishme që është në tabelë është numri i çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm, me qëllim përlllogaritjen e rendimentit të gjyqtarit. Çështja e rendimentit të gjyqtarit ka qenë një element që është llogaritur edhe më parë por në këtë rast ligji na detyron që atë ta kemi element të domosdoshëm të tabelës dhe është futur edhe ky rendiment si element i tabelës. Është llogaritja që vetë ligji e parashikon si një raport midis numrit të çështjeve të caktuara me numrin e çështjeve të gjykuara. Rendimenti është shumë i rëndësishëm për llogaritje, por duke marrë parasysh që ai nuk tregon realisht, domethënë në këtë rendiment nuk përfshihen numri i çështjeve të mbartura, për ta kontrolluar edhe saktësinë e statistikave, kemi parashikuar në këto statistika që rubrika e çështjeve të mbartura të parashikohej edhe më vete, pra si e dhënë statistikore.

Në hartimin e tabelave dhe përcaktimin e numrit të tyre për çdo gjykatë, sipas juridiksionit dhe shkallës së gjykimit, është mbajtur në vëmendje kategorizimi i natyrës së çështjes, referuar objektit të mosmarrëveshjes, kategorizim i bërë nga vetë ligjet procedurale; kategorizimi i çështjeve sipas fazës procedurale (pra çështje themeli, hetimi

paraparak, seancë paraprake, fazës ekzekutimit etj.) dhe evidentimi në tabela të veçanta i çështjeve të vlerësuara me karakter të posaçëm, referuar objektit të mosmarrëveshjes ose ligjit të posaçëm që rregullon një fushë të caktuar.

Hartimi i tabelave me të dhëna statistikore për kategori specifike çështjesh, veç ndarjes së përgjithshme që bëjnë dispozitat procedurale, ka për qëllim të krijojë një bazë të dhënash për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim nga të gjitha kategoritë, duke bërë të mundur evidentimin e aftësive profesionale të gjyqtarit mbi të dhëna gjithëpërfshirëse sipas parashikimeve të nenit 91 të ligjit nr.96/2016. Për këtë arsye janë hartuar disa tabela statistikore për kategori të posaçme çështjesh.

Edhe një herë dua të theksoj që ndarja e çështjeve ose tabelave për kategori çështjesh, lehtëson procedurën e përzgjedhjes së çështjes me short. Çka do të thotë, duke qenë se ligji detyron që përzgjedhja të bëhet pothuajse objektive dhe në mënyrë të barabartë për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke evidentuar marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet e punës, çështjet tregtare, çështjet civile të përgjithshme, për çështjet civile dhe ato penale në kategori të veçanta, do të shikohet, domethënë realizohet mundësia e përzgjedhjes nga një çështje ose më shumë, për secilën kategori. Dhe kështu vlerësohet edhe më mirë aftësia profesionale e gjyqtarit.

Për këtë arsye, janë hartuar disa tabela statistikore për kategori të posaçme çështjesh. Për shembull: a. Për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat administrative, është përcaktuar në një tabelë të veçantë kategoria e çështjeve që kanë për objekt mosmarrëveshjet lidhur me marrëdhëniet e punës, referuar fushës specifike, volumit të përgjithshëm të këtyre çështjeve, karakterit sensitiv dhe standardit minimal kohor që vetë Këshilli duhet të përcaktojë për këto marrëdhënie, referuar edhe orientimeve të CEPEJ-it. b. Për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat për krime të rënda/gjykatat e posaçme është hartuar një tabelë e posaçme për çështjet që lidhen me zbatimin e ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, me qëllim përzgjedhjen për vlerësim të çështjeve të kësaj natyre dhe rëndësisë specifike në aspektin procedural dhe material, me qëllim

evidentimin dhe vlerësimin e njohurive të gjyqtarit në dimension sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirës.

Për sa i përket përmbajtjes së tabelave, janë të përcaktuara. Ato kanë numër rendor, numër akti, datë regjistrimi, etj. Janë të përcaktuar përmbajtja e tyre. E keni edhe në format shkresor, gjithashtu edhe në relacion. Shpjegohet në relacion çdo e dhënë dhe çfarë duhet të përfshihet në këtë të dhënë.

Përveç këtyre të dhënave, që janë të njëjta për të gjitha tabelat statistikore, në gjykatën e apelit, siç u evidentua, është parashikuar edhe kolona e “nxjerrjes së çështjes për gjyq”. Veç kësaj është parashikuar edhe një tabelë më vete për gjykatën e apelit, për çështje që gjykata e apelit i ka siç i gjykon, për shkak të juridiksionit fillestar që ajo ka.

Përveç tabelave për secilën shkallë dhe lëndë, sipas kompetencave lëndore të gjykatave është përcaktuar: për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe për të gjitha gjykatat e tjera dhe një tabelë përmbledhëse, e cila përmban të dhëna statistikore lidhur me: natyrën e çështjeve; çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm; çështjeve të caktuara si relator; rendimentit, etj.

Tabela përmbledhëse hartohet për çdo vit kalendarik dhe është pikërisht ajo tabelë ku gjen pasqyrim numri i kërkesave për përjashtim të gjyqtarit, në raport me ato të pranuar dhe të rrëzuara dhe numri i kërkesave për heqje dorë, në raport me ato të pranuar dhe të rrëzuara, për efekt edhe të kriterëve dhe treguesve që kemi miratuar në metodologji.

Për sa i përket prezantimit të tabelave, për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë, tabela ka, për çështje civile të përgjithshme me palë kundërshtarë dhe pa palë kundërshtarë. Pse është bërë ky dallim?

Dallimi diktohet nga vet nevojat e ligjit. Vet ligji 96/2016 përkufizon se çfarë do të konsiderohet çështje civile pa palë kundërshtarë dhe përcakton një numër të caktuar të këtyre çështjeve që duhet të hiqen për vlerësim. Për këtë arsye është bërë ndarja e çështjeve me palë kundërshtarë dhe pa palë kundërshtarë, për çështjet civile të përgjithshme. E njëjta ndarje është bërë edhe për çështjet familjare, për çështjet tregtare. Marrëdhëniet e punës janë grupuar në tabelë më vete.

Për sa i përket lëndës penale, tabelat përmbajnë ndarje të çështjeve për krime, kundravajtje penale, për çështje të fazës së hetimit paraprak, të seancës paraprake, të gjykimit të themelit, të fazës së ekzekutimit të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, dhe siç u shpjegua është një tabelë më vete për shpejtësinë dhe volumin e çështjeve në kuadër të ligjit Antimafia.

Në relacion shpjegohet se kush do të përfshihet në çështjet civile me palë kundërshtare, pa palë kundërshtare, familjare, etj., të gjitha këto që kanë të bëjnë me gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Në tabelën e kërkesave penale gjatë hetimit paraprak është parashikuar që veç masave të sigurimit që lidhen me fazën e hetimit paraprak, kërkesave të tjera për përgjime, sekuestrime, etj., do të përfshihen edhe kërkesat që kanë të bëjnë me masat e sigurimit në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, pavarësisht se ato i referohen çështjeve që kanë të bëjnë me një fazë tjetër të zhvillimit të gjykimit.

Gjithashtu është parashikuar që në këto tabela do të futen edhe kërkesat që kanë lidhje me masat e sigurimit, por që nuk bëhen gjatë hetimeve paraprake por që mund të bëhen nga gjyqtari i seancës paraprake për kërkesa për masë zëvendësim, bashkim, etj. (mund të ndodhin gjatë gjykimit). Kjo ka qenë për shkak se nga takimet që kemi patur me kancelarët e gjykatave edhe më përpara, çështja e statistikave është shumë problematike në gjykatë sepse si i regjistron çështjet një gjykatë, nuk i regjistron një gjykatë tjetër. Disa gjykata, për shembull, kërkesën për masë sigurimi edhe pse bëhet gjatë gjykimit, e regjistrojnë si çështje themeli. Jo! Kërkesa për masë sigurimi, pavarësisht se në ç'fazë të gjykimit regjistrohet, duhet të regjistrohet tek tabela e kërkesave gjatë hetimit paraprak. I kemi sqaruar të gjitha këto.

Me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale është futur seanca paraprake. Ka një kompleksitet çështjesh dhe një natyrë të ndryshme, të cilat i kemi pasqyruar në tabelë më vete. Po kështu krimet dhe kundravajtjet penale janë pasqyruar në tabela më vete. Në tabela më vete është pasqyruar se ku do të regjistrohen çështjet që kanë të bëjnë me miratimin e urdhrave penal apo miratimin e marrëveshjeve. Po kështu edhe çështjet që

kanë të bëjnë me ekstradimet apo me njohjet e vendimeve penale të huaja. Kjo për sa i përket gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjykata e apelit të juridiksionit të përgjithshëm ka të njëjtën tabelë statistikore, me të vetmin ndryshim që, gjykata e apelit të juridiksionit të përgjithshëm ka edhe një tabelë për çështje të juridiksionit fillestar, të cilat ajo i shqyrton në bazë të Kodit të Procedurës Civile ose në bazë të ligjeve të veçanta.

Për sa i përket gjykatave të posaçme, që kemi gjykatën administrative dhe gjykatën e posaçme antikorrupsion, tek gjykata administrative numri i tabelave është më i vogël (janë gjithsej 5 tabela); çështje me palë dhe pa palë kundërshtare dhe çështjet e marrëdhënieve të punës, gjithashtu edhe tabela përmbledhëse, për shkak se kjo gjykatë gjykon çështje të një natyre, të një lënde të përcaktuara (të themi), ku ndarja bëhet midis vetëm mes çështjeve me palë kundërshtare ose pa palë kundërshtare.

E njëjta gjë edhe për gjykatën e apelit, administrative të apelit.

Për sa i përket Gjykatës për Krimet e Rënda, siç ju theksova, është marrë parasysh në hartimin e tabelave, kompetencat që kjo gjykatë ka patur, që i referohet programit të vlerësimit për vitin 2020, pra 2017 – 2019 të periudhës së vlerësimit, ndërkohë që në të ardhmen është marrë parasysh edhe natyra e çështjeve që do të gjykojë kjo gjykatë edhe për shkak të subjekteve ku duhet të shtohen edhe kundravajtjet penale por aktualisht nuk është miratuar një tabelë për Gjykatën e Posaçme Antikorrupsion për kundravajtjet penale, duke marrë parasysh që ne kemi periudhë vlerësimi vetëm 2017 - 2019 dhe çështjet që do të futen në program vlerësimi janë vetëm ato që Gjykata e Krimeve të Rënda ka patur për shqyrtim.

Megjithatë, tabelat, në varësi të nevojës që mund të kenë edhe gjykata pas krijimit të tyre, sigurisht që mund të pasurohen dhe mundet të modifikohen në vazhdim.

Ky ishte pak a shumë një prezantim i 50 tabelave që i keni në format shkresor.

Me anë të këtij vendimi kemi parashikuar gjithashtu që këto tabela do të përpilohen edhe në format elektronik sepse mbushja e tyre nga personat përgjegjës do të kryhet në rrugë elektronike. Vlera e formatit elektronik dhe e formatit shkresor të tabelës është e njëjtë.

Bashkëngjitur vendimit është Lidhja nr. 1 e cila specifikon dhe i numërton të gjitha tabelat (janë 50 tabela), dhe Lidhja nr. 2 e cila ka të pasqyruar formatin shkresor dhe përmbajtjen që duhet të ketë secila tabelë.

Zonja Kryetare, ndoshta miratimi i këtij vendimi e vlerësoj shumë të rëndësishëm sepse duke filluar nga viti 2020 e në vazhdim, gjykatat duhet të fillojnë t'i dokumentojnë dhe regjistrojnë çështjet sipas këtyre tabelave, me qëllim që të mos kenë vështirësi në të dhënat statistikore që na japin. Edhe sistemi i menaxhimit të çështjeve, kam përshtypjen që duhet të orientohet në momentin kur ai do të krijohet ose do të përmirësohet, sipas përmbajtjes së këtyre tabelave.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Në fakt, edhe unë e gjej shumë me vend miratimin e këtij projektvendimi.

Siç jeni në dijeni, në zbatim të nenit 82 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin që të raportojë përpara Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor për vitin pararendës. Që do të thotë që, këto tabelat duhet të fillojnë direkt që t'i shpërndahen kryetarëve të gjykatave, sikurse keni parashikuar ju edhe tek rregullorja (tek vendimi 263), që brenda janarit, ato të na përcjellin të dhënat, të cilat ne, jo vetëm për efekt të vlerësimit që ju mund t'ju duhet, por na duhen edhe për efekt të raportimit përpara Kuvendit të Shqipërisë.

Ju jeni në dijeni që ne kemi bërë një lloj raportimi dhe kemi marrë disa indikatorë, të paktën me sa mundeshim të merrnim, meqenëse ish-KLD-ja nuk kishte bërë një lloj vlerësimi të gjendjes së gjyqësorit dhe unë mendoj që këto lloj tabelash do të na ndihmonin.

Atë që unë do sugjeroja dhe kjo varet edhe nga vullneti, është që, ndoshta me të gjithë kancelarët dhe kryetarët të cilët mbushin këto lloj tabelash, duhet bërë një lloj trajnimi, sqarimi, ndoshta mund të na ndihmojnë edhe partnerët ndërkombëtarë, lidhur me mënyrën se si ato duhet ta plotësojnë këtë.

Do preferoja që brenda janarit, ne këtë gjë, përpara se ato ta plotësonin, të bënim një lloj trajnimi, me idenë që, ne kur të marrim të dhënat dhe t'i përpunojmë, si për efekt ju të vlerësimi, ashtu edhe për efekt të gjendjes, për të parë një situatë, një panoramë të

gjendjes së gjyqësorit për raportim, të kemi, të na koordinojnë apo të na përputhen të dhënat.

Nëse nuk keni ndonjë diskutim, atëherë kalojmë lidhur me miratimin e projekt-aktit të propozuar nga Komisioni, sipas tekstit të propozuar.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e tabelave standarde me të dhëna statistikore të nevojshme për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas listimit dhe formatit bashkëlidhur, pjesë të këtij vendimi përbërëse Lidhja 1 Lidhja 2.

2. Tabelat hartohen në format shkresor dhe elektronik që kanë vlerë të njëjtë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.12.2019)

Pika 6 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

11. Marçela Shehu

(anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 5. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 6. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 11. Erion Fejzulla, USAID.**
- 12. Valbona Bala, USAID.**
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.**

RENDI I DITËS:

6. (Pikë shtesë) Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë”.

Naureda Llagami: Atëherë, për të menaxhuar në fakt edhe kohën, duke qenë se seanca... Unë do sugjeroja që në rendin e ditë të vazhdonim me propozimet lidhur me ngritjen e dy Komisioneve të Përkohshme. Viojmë të përfshijmë ato të rend dite dhe më pas të diskutojmë çështjet e tjera.

I përfshimë! Por t'i përfshijmë tani përpara renditjes që kemi. T'i marrim në shqyrtim.

Atëherë, fillojmë me projektvendimin e parë, i cili është propozuar nga zoti Medi Bici.

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar planin e tij strategjik në korrik të vitit 2019. Ka përfshirë në planin e tij strategjik si një nga objektivat më prioritare të tij, marrjen e masave lidhur me reduktimin e backlog-ut/të stokut të çështjeve në Gjykatën e Lartë.

Kuptohet, ky projekt marrjeje masash pa diskutim, që kërkon një punë analizuuese dhe sikurse kemi parashikuar në planin tonë strategjik, kjo lloj pune do bëhet në koordinim edhe me dy partnerët tanë ndërkombëtarë, që është “Drejtësi për të gjithë” dhe “EURALIUS”. Për më shumë detaje unë do doja t'ia jepja fjalën zotit Medi Bici, i cili do të na propozojë edhe ngritjen e një Komisioni të Posaçëm për shqyrtimin dhe miratimin e këtij plani masash. Faleminderit!

Zoti Bici!

Medi Bici: Faleminderit, zonja Kryetare!

Ashtu siç e thatë edhe ju, në planin tonë strategjik për këtë vit, ne kemi parashikuar se si mund të arrijmë që të ulim numrin e çështjeve që janë në Gjykatën e Lartë, që kanë kaluar shifrën 30 mijë. Pra, për këtë, duhet të kemi parasysh se në përbërje të këtyre çështjeve ka shumë çështje që kapin një shifër më pak se 1 milion lekë, e cila në bazë të ligjit “Për Gjykatat Administrative” nuk mund të shqyrtohen në Gjykatën e Lartë çështje që kanë sasinë e çështjeve mbi 40-fishin e vlerës së pagës minimale në shkallë vendi; gjithashtu një numër të madh të çështjeve e përbëjnë çështjet që kanë të bëjnë me faturat e energjisë elektrike dhe sidomos ato me faturat e telefonave, që kanë një vlerë

shumë të vogël; dhe pjesa tjetër e çështjeve janë që vijnë nga marrëdhëniet e punës dhe që gjykohen për vlera shumë të vogla.

Duke u nisur nga këto fakte, komisionet janë dakordësuar që të ketë në përbërje të këtij Komisioni të Përkohshëm nga një anëtar, kështu që meqenëse unë bëj pjesë në dy komisione, në Komisionin e Disiplinës dhe në Komisionin e Planifikimit Strategjik dhe të Administrimit të Buxhetit, u arrit që të bëjë pjesë në këtë, pra të përfaqësoj dy komisione dhe në komisionet e tjera të përfaqësuara si Komisioni i Vlerësimit dhe i Etikës së Veprimtarisë Profesionale dhe Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, ne i propozojmë Këshillit që të ngremë një Komision të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, me këtë përbërje: Medi Bici, kryetar, Brunilda Kadi, anëtare dhe Alban Toro, anëtar.

Në mbledhjet e këtij komisioni ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga Gjykata e Lartë, nga Misioni EURALIUS V, dhe nga projekti “Drejtësi për të gjithë” i USAID-it.

Ushtrimi i veprimtarisë së Komisionit, do të fillojë nga data 6 janar deri më 31 mars 2020, afat brenda të cilit, Komisioni duhet të depozitojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor planin e përgatitur në funksion të qëllimit për të cilin ai është ngritur.

Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri kryetari i këtij Komisioni dhe anëtarët e tij. Në përmbushjen e punës së tij komisioni ata do të asistohet nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky ishte propozimi ynë.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimin për ngritjen e Komisionit, sugjerim?

Atëherë, e hedhim në votim miratimin e Komisionit të Përkohshëm/Posaçëm lidhur me trajtimin e kësaj çështjeje?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, me këtë përbërje: z. Medi Bici, kryetar; znj. Brunilda Kadi, anëtare; z. Alban Toro, anëtar.

Në mbledhjet e këtij Komisioni ftohen të marrin pjesë përfaqësues të Gjykatës së Lartë, të Misionit EURALIUS V, projekti “Drejtësi për të gjithë” - USAID.

Ushtrimi i veprimitarisë së Komisionit, fillon nga data 6 janar deri më 31 mars 2020, afat brenda të cilit, Komisioni duhet të depozitojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor planin e përgatitur në funksion të qëllimit për të cilin është ngritur.

Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri kryetari i këtij Komisioni dhe anëtarët e tij. Në përmbushjen e punës së Komisionit, do të asistohen nga stafi administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.12.2019)

Pika 7 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

11. Marçela Shehu

(anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.**
- 5. Elsma Shehu, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 6. Rudina Palloj, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 7. Elisa Stamo, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 8. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 9. Flojera Davidhi, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 10. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 11. Erion Fejzulla, USAID.**
- 12. Valbona Bala, USAID.**
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.**

RENDI I DITËS:

7. (Pikë shtesë) Shqyrtimi i projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër, e cila nuk është më pak e rëndësishme edhe ajo. Bëhet fjalë edhe në këtë rast lidhur me ngritjen e një Komisioni të Përkohshëm për hartimin e rregullave të brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç jeni në dijëni, edhe kjo është një çështje prioritare e Këshillit sepse këto lloj rregullash do kenë parasysh së pari pjesën, përcaktimin më së fundmi të fushës së veprimtarisë së secilit komision; rregulla që kanë të bëjnë me organizimin dhe mbledhjen plenare; dhe rregulla, pse jo, të pjesës administrative.

Për më shumë detaje, ia jap fjalën zëvendëskryetarit, zotit Maksim Qoku, për relatimin e projekt-aktit të propozuar.

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, përveçse do detajoja disa gjëra, nuk kam pse të shtoj sepse tashmë jemi të gjithë në dijëni të faktit që nevoja e një rregulloreje është evidente. Shpeshherë në punën tonë ne na kanë dalë debate ose ngërçe të tipit interpretimit ose të një parashikimi më të ngushtë, gjë që e cila e ka nxjerrë edhe më në pah këtë nevojë. Nisur nga angazhimet e muajve të fundit dhe në tavolinën e përbashkët që bëmë me ekspertë të USAID-it dhe EURALIUS-it në lidhje me këtë problematikë, ne arritëm në përfundimet që na nevojiteshin, kështu që e vetmja gjë që më duhet të them është fakti që ne nuk është se e kemi neglizhuar faktin e pasjes së një rregulloreje, por kuptohet që si vit i parë i yni i punës, kemi qenë të angazhuar në akte që shpeshherë lidheshin me afate ligjore, por mbi të gjitha dhe në akte të aspektit emergjent që na ka detyruar të anashkalojmë një situatë të tillë.

Kështu që nisur nga të gjitha këto që thashë dhe ato që tha Kryetarja, unë përpilova dhe bëj propozim një projektvendim për ngritjen e një Komisioni me përbërjen anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Natyrisht, në pikat që ka parashikuar vendimi është: Pika e parë, aspekti i paraqitjes së objektivës të çfarë do të realizojë ky grup pune.

Është dhënë përbërja e anëtarëve të Komisionit, që jemi të larmishëm sipas Komisioneve të Përhershme.

Natyrisht, në pikën 3 është theksuar bashkëpunimi i ngushtë me të dy misionet EURALIUS dhe “Justice for All”.

Dhe ndër të tjera është marrë parasysh që, përveçse të jetë vazhdimisht bashkëpunimi me administratën, Komisioni të mund të parashikojë edhe rregulla, për të qenë luajal dhe fleksibël në aspektin e veprimtarisë që mund të kryejë gjatë kohës.

Në fakt ne nuk parashikuam një afat për deri kur mund të zgjaste, por mbase tek pjesa e faktit që mund të përcaktojmë rregulla, ne me Komisionin (anëtarët) mund të ndajmë në bashkëpunim me ekspertët, se deri kur të vihet një draft në dispozicion, në mënyrë që pastaj të kalojë në debatin midis anëtarëve të Këshillit.

Kështu që, për më tepër, aktin ju e keni dijëni dhe e kemi biseduar. Ju ftoj që ta votojmë këtë projektvendim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Qoku!

Personalisht, unë do doja në fakt, ndoshta vetëm çështjen e afatit, të vendosim një afat të arsyeshëm, që juve e gjykoni sepse është e mirë edhe në objektivat dhe ashtu kemi ecur edhe me praktikën e komisioneve që kemi krijuar në mënyrë të përkohshme. Unë do të propozoja që të kishim një afat. Jua lë juve si iniciatori dhe draftuesi i projekt-aktit, që të mendoni një afat të arsyeshëm sepse kjo është një praktikë që neve e kemi ndjekur edhe në gjithë komisionet e tjera.

Maksim Qoku: Në fakt ne nuk vumë afat sepse jemi në varësi të ekspertit sepse bashkëpunimi do ishte i tillë që ne bëjmë një farë përqendrimi të pikave në lidhje ku do përqendrohemi dhe i cili ai të na vinte në dispozicion një draft, -vetëm kjo ishte ideja. Por mund të vëmë një afat 2-mujor. Megjithëse ç’do sillte ky afat?

Brunilda Kadi: S’ka pasoja juridike kjo.

Ja s’e zbatuam?!

Maksim Qoku: Se interesi ynë që të ngutemi ta bëjmë sa më shpejt.

Pra drafti të vijë në debat me anëtarët.

(Zonja Llagami flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Mund ta bëjmë edhe 3-mujor dhe 4, por për pjesë objektiviteti...

Maksim Qoku: Atëherë, do të propozoja një pikë të veçantë një afat 3-mujor.

Brunilda Kadi: Unë mendoj që nuk ka nevojë që të vëmë afat sepse kur merr një vendim dhe vendos ca rregulla, duhet të kenë ca pasoja juridike dhe unë nuk e di çfarë pasojash juridike ka në qoftë se ne nuk respektojmë afatin. Se tani, që jemi të përgjegjshëm që do ta bëjmë sa më shpejt, kjo nuk vihet në dyshim. Kështu që nuk e kuptoj arsyen e afatit dhe s'e kam kuptuar me thënë të drejtën as herën e parë kur u vu. Me sa më kujtohet është vënë afat për Komisionin për inspektorët, që është kapërcyer nja 100 herë ai afat. Ndoshta e ekzagjeroj 100 herë, por 10 po njëherë. Kështu që nuk mendoj që ka sens të vejmë afat.

Naureda Llagami: Si thoni propozojmë një afat 3-mujor Maksi? Si e gjykon? 4!

Por neve duhet të jemi koshient në pjesën e vendosjeve të afateve sepse jo se ka ndonjë gjë, por ka pjesën e planifikimit të punës dhe planifikimit të gjithë çështjeve të tjera, aq më shumë që është çështje prioritare për ne.

Brunilda Kadi: Në qoftë se nuk e bën, shkrihet Komisioni?

Çfarë ndodh po s'u bë?

Ti vendos ca rregulla që je i detyruar t'i zbatosh.

Vure rregull kush do jetë anëtar Komisioni dhe çfarë do ketë objekt. Ky ishte rregulli.

Çfarë pasoje ka afati?

Maksim Qoku: Atëherë, e lejmë për një afat tremujor. Gjithsesi performancën e KLGJ-së shpreh, asgjë tjetër.

Naureda Llagami: Atëherë, hedhim në votim propozimin...

Marçela Shehu: Më fal, tek baza ligjore është parashikuar, përveç parashikimeve të Kushtetutës, e kemi folur edhe me Maksin, neni 61, pika 1, shkronjat /f/ dhe /j/, mendoj që duhet shtuar edhe pika /i/ (/f/, /j/ dhe /i/) sepse rregullorja e brendshme e Këshillit do të përfshijë rregullat sipas pikës /f/, /j/ dhe /i/ të nenit 61.

Naureda Llagami: Më falni edhe njëherë, se nuk e kisha ndezur.

Atëherë, kalojmë në propozim projekt-aktin së bashku me dy sugjerimet. Sugjerimi i parë ishte shtesa në bazën ligjore të shkronjës /i/ të nenit 61, pika 1 dhe e

dyta, përcaktimi i një afati tremujor që Komisioni brenda të cilit do t'i propozojë një produkt Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me rregullat e brendshme.

Brikena Ukperaj: Ndoshta për të ndjekur të njëjtën analogji si tek vendimi më parë që miratuam, siç e miratuam të parin, duhet të përcaktohet kur e fillon ushtrimin e veprimtarisë Komisioni dhe kur... Se ndoshta... Direkt? Okej, në rregull!

Naureda Llagami: Pra e hedhim edhe një herë në votim duke marrë të dyja sugjerimet, për afatin dhe për shtesën në bazën ligjore.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord, me rezervën për punën e afatit, për atë pjesë jam kundër. Kështu që. Në parim për aktin jam dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u bazuar në nevojën institucionale për të patur një rregullim më të detajuar në lidhje me mirëfunksionimin, rritjen e efikasitetit dhe cilësinë e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Komisioni i Përkohshëm për hartimin e Rregullores së Brendshme ka këtë përbërje: z. Maksim Qoku, kryetar; z. Medi Bici, anëtar; znj. Brunilda Kadi, anëtare; znj. Fatmira Luli, anëtare; znj. Marçela Shehu, anëtare;

Komisioni koordinon punën e tij dhe fton për bashkëpunim përfaqësues të Misionit EURALIUS V, projektit “Drejtësi për të gjithë” – USAID, prezenca e OSBE-së në Tiranë dhe projektit “SEJ III” – i Këshillit të Evropës.

Në përmbushje të punës së tij Komisioni merr masa dhe orienton administratën për të asistuar në mbarëvajtjen e punës së Komisionit.

Brenda një afati tremujor nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, Komisioni i depoziton Këshillit të Lartë Gjyqësor një projekt-rregullore.

Komisioni mund të miratojë rregulla për funksionimin e veprimtarisë së tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

(Pika 7 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 19.12.2019)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Dëgjuesë me gjyqtarin {...} i cili ka paraqitur kërkesë për rikthimin në detyrën e gjyqtarit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 14:20.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

RENDI I DITËS:

8. Dëgjësë me gjyqtarin {...} i cili ka paraqitur kërkesë për rikthimin në detyrën e gjyqtarit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës.

Atëherë, duke qenë që kemi të bëjmë me tre çështje të cilat kanë informacione personale dhe sensitive, i ftoj të gjithë të pranishmit të largohen.

Kalojmë me rendin e ditës për shqyrtimin e projekt-aktit lidhur me kërkesën për rikthimin në detyrën të gjyqtarit, {...}. Siç e kemi lënë në mbledhjen pararendëse, me vendim të Këshillit kemi vendosur që ish-gjyqtarin {...} ta thërrasim, gjyqtarin {...} ta thërrasim për ta dëgjuar në mbledhjen plenare.

Përpara se ta ftojmë në mbledhje plenare, lidhur me propozimin e projekt-aktit, ia jap fjalën zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: E ka fjalën relatorja e çështjes, zonja Shehu!

Naureda Llagami: Po!

Marçela Shehu: Po! Faleminderit Kryetare!

Gjyqtari {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, bazuar në nenin 151 e vijues të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 24.12.2018, i është drejtuar me kërkesë Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke kërkuar rikthimin e tij në detyrë, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë si dhe pagën dhe të gjitha përfitimet e tjera për të gjithë kohën e qëndrimit të tij pa punë.

Ka rezultuar gjatë analizës së situatës faktike që lidhet me shqyrtimin e kërkesës së gjyqtarit {...}, se me vendimin 47, datë 29.04.2015 “Mbi pezullimin nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, z. {...}“ Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: Të pezullojë nga ushtrimi i detyrës gjyqtarin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë z. {...}, deri në marrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë për çështjen penale në ngarkim të tij. Ky vendim është marrë pasi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ishte regjistruar procedimi penal nr.8168 i vitit 2014, në ngarkim të të

pandehurit {...} për kryerjen e veprës penale “Refuzimi për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarimi i rremë i personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë” parashikuar nga neni 257/a, paragrafi 2 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr.3435, datë 13.10.2015 ka vendosur: Pushimin e gjykimit të çështjes në ngarkim të të pandehurit {...} për kryerjen e veprës penale “Refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarimi i rremë i personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë” parashikuar nga neni 257/a, paragrafi 2 i Kodit Penal, pasi mungojnë elementët e veprës penale.

Kundër vendimit të mësipërm është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo gjykatë me vendimin e saj nr.241, datë 02.03.2016 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.3435, datë 13.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi, gjyqtari {...} ka depozituar në KLD, kërkesën datë 29.03.2016, mbi revokimin dhe heqjen e masës së pezullimit nga detyra e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, marrë me vendimin nr. 47, datë 29.04.2015, të KLD-së.

Gjithashtu, ka paraqitur në Këshill edhe kërkesën e datës 07.11.2016 me lëndë “Kërkesë për revokimin e masës së pezullimit nga detyra...”.

Ka rezultuar gjithashtu se ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga prokurori i Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 394, datë 18.05.2007 (*lapsus viti, pasi është 2017*) ka vendosur: Mospranimin e rekursit të ushtruar nga prokurori i apelit Tiranë kundër vendimit nr.241, datë 02.03.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Pas përfundimit të gjykimit të çështjes edhe në Gjykatën e Lartë, gjyqtari {...} ka riparaqitur kërkesën e tij edhe më datë 14.06.2017 me objekt “Rikthimi në detyrë” drejtuar ish-KLD-së si dhe kërkesën e tij datë 24.12.2018 që ia ka paraqitur KLGJ-së, pas ngritjes së saj.

Kemi parashtruar edhe situatën ligjore që rregullon situatën në fjalë në rastin konkret. Gjyqtari është pezulluar në bazë të nenit 29 të ligjit 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, i cili ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së kësaj mase.

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, në referim të dispozitave ligjore që janë cituar në relacion si dhe në analizë të rrethanave faktike të parashtruara, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vlerëson se shkak për të cilin është vendosur pezullimi nga detyra i gjyqtarit {...}, me vendimin nr. 47, datë 29.04.2015, aktualisht nuk ekziston më, pasi me vendimin nr. 3435, datë 13.10.2015 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga apeli duke vendosur edhe mospranim rekursi nga Gjykata e Lartë, tashmë është vendosur pushimi, dhe në këto kushte, në referim të nenit 151 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni vlerëson, se në kushtet kur çështja penale, shkak i pezullimit nga detyra të gjyqtarit {...}, tashmë është pushuar me vendim penal të formës së prerë, vendimit të pezullimit nga detyra, i kanë pushuar efektet ligjore. Ndaj, ky Komision, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Të rikthejë në detyrë gjyqtarin {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë si dhe të njohë të drejtën e tij për përfitimin e pagës për të gjithë kohën e pezullimit nga detyra, pra që nga data 29.04.2015.

Komisioni propozon gjithashtu, nëse Këshilli e vlerëson me vend, që aktet t'i kalojnë për trajtim ILD-së, në momentin e ngritjes së saj, me qëllim që të vlerësojë kjo e fundit, nëse ka vend për nisjen apo jo të një procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit {...} lidhur me faktet që kanë rezultuar gjatë procesit penal. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, siç e kemi lënë edhe në mbledhjen e datës 29 tetor të 2019, me vendim të Këshillit kemi thënë që do bëjmë një dëgjese me gjyqtarin {...}, kështu që pas relatimit unë do doja që ta ftonim zotin {...} për të na parashtruar kërkesën e tij dhe nga anëtarët nëse ka ndonjë pyetje dhe sqarim lidhur me kërkesën që ai ka parashtruar.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari {...}.)

Përshëndetje zoti {...}!

{...}: Përshëndetje!

Naureda Llagami: Jeni ftuar në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor për të na shpjeguar lidhur me kërkesën që ju i keni parashtruar Këshillit të Lartë Gjyqësor për t'ju rikthyer në pozicionin e punës tuaj. Shkurtime!

{...}: Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Ju kam paraqitur një kërkesë për kthim në punë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Meqenëse jemi në seancën dëgjimore, po kërkoj revokimin e vendimit të pezullimit të rikthimit të statusit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë; Urdhërimin e organit kompetent Zyrës së Buxhetit Gjyqësor për të më paguar pagën dhe përfitimet e tjera, përfshirë edhe pagesat për sigurimet shoqërore, të gjithë kohën e qëndrimit pa punë, duke filluar nga data e pezullimit 29.04.2015 deri në ditën që do të kem statusin e gjyqtarit.

Në datën 15.01.2020 mbush moshën 65 vjeç dhe kam të drejtë për pension të parakohshëm pleqërie. Në bazë të nenit 27 të ligjit 96/2016 kërkoj që me mbarimin e statusit të gjyqtarit, siç është dita e sotme që po kërkoj dorëheqjen, kërkoj përfundimisht dorëheqjen time si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Kaq kisha unë për të dhënë në këtë kërkesë dëgjimore nga ana juaj. Po të keni ndonjë gjë, mund t'ju përgjigjem.

Ilir Toska: Atëherë, kërkesa juaj për dorëheqje e keni me shkrim?

{...}: Urdhëro?

Ilir Toska: Kërkesën për dorëheqje, e keni me shkrim apo jo?

{...}: I nderuari zoti anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, kjo është kërkesë dëgjimore dhe derisa është kërkesë dëgjimore, nuk paraqitet dokument me shkrim. Në kërkesën dëgjimore dëgjohesh edhe pastaj konkludoni ju, vendosni ju. Nuk paraqitet, i nderuar! Nuk paraqitet!

Ilir Toska: Atëherë, sipas ligjit, nëse keni kërkesë për dorëheqje nga statusi i magjistratit, kërkesa bëhet me shkrim. A e keni një kërkesë të tillë apo jo?

{...}: Më falni! Është kërkesë dëgjimore. Nuk paraqitet me shkrim. Kërkesë dëgjimore. Për këtë më ka thërritur Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nuk më ka thërritur që të paraqesë ndonjë kërkesë me shkrim. Të lutem! Më fal i nderuar!

Ilir Toska: Nëse Këshilli do duhet të konsiderojë një kërkesë tuajën për dorëheqje nga statusi i magjistratit, duhet që kërkesa të jetë me shkrim. Ndaj po ju pyes.

{...}: Më falni! Unë jam në kërkesën dëgjimore.

Më fal! Ta thashë edhe një herë!

Më fal! Unë të thashë!

Jam në kërkesën dëgjimore. Kërkesën dëgjimore unë e bëj me gojë.

Dhashë dorëheqjen. Ju lutem, mund të merrni vendimin që mendoni ju!

Marçela Shehu: Po! Zoti {...}, të falënderojmë që keni ardhur! Të dëgjuam.

Në parashtresën tuaj -sigurisht që kjo është një seancë dëgjimore -në parashtresën tuaj, ju parashtruat dy kërkesa. Ju thatë që kërkonti që të revokoni vendimin e ish-KLD-së për rikthimin...

{...}: Po! Se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka marrë një vendim nr. 49 i datës 29.04.2015 dhe mua më ka pezulluar nga detyra zonjë. Dhe patjetër, duhet të hiqet ajo kërkesë e KLGJ-së, e pezullimit, që të vijnë kërkesat e tjera.

Marçela Shehu: Po, zoti {...}! Dhe të gjitha këto ne i kemi të qarta.

Përveç këtij momenti, ju për herë të parë, në këtë seancë, po thoni – është një rrethanë që Këshilli nuk e dinte më përpara – që ju hiqni dorë nga statusi i gjyqtarit. Kjo kërkesë, -të lutem më dëgjo deri në fund, -kjo kërkesë, sipas ligjit, duhet të bëhet me shkrim. Pra ju keni...

(Zoti {...} ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Të lutem! Jo! Të lutem, më dëgjo deri në fund.

{...}: Ia sqarova edhe kolegut tuaj, e nderuara zonja anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ju lutem! Kjo është kërkesë dëgjimore. Derisa është kërkesë dëgjimore, bëhet vetëm me gojë, nuk bëhet me shkrim.

E nderuar, më falni!

Më falni! Kjo është kërkesë dëgjimore.

Unë për këtë jam thirrur. Më falni!

Marçela Shehu: Atëherë, edhe një herë.

Ju jeni thirrur sot për t'u dëgjuar lidhur me kërkesën tuaj për rikthimin në detyrë, ndërsa për dorëheqjen tuaj Këshilli është hera e par që vihet në dijeni lidhur me këtë deklaram.

Të lutem! A ka problem nga ana juaj që kjo kërkesë të paraqitet me shkrim?

{...}: Dëgjo, e nderuara anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Unë kërkesën me shkrim e kam paraqitur dhe ju të gjithë si anëtarë të Këshillit Gjyqësor e keni të gjithë dokumentacionin e nevojshëm çfarë kam paraqitur unë deri më sot. Sot unë erdha në kërkesë dëgjimore dhe në këtë kërkesë dëgjimore po ju paraqes këtë dorëheqjen time, edhe jua thashë pikat a mia, siç jua thashë më parë. Dakord?! Siç jua thashë më parë.

Alban Toro: {...}, këtë që the, shko tek protokollin dhe depozitohet! Këtë që the. Kaq gjë e bën dot për ne?

{...}: Urdhëro?

Alban Toro: Këtë që the, dorëheqjen, e depoziton dot tek protokollin?

(Zoti {...} flet pa ndezur mikrofonin.)

E kuptuam pra, e kuptuam.

Në përfundim të seancës dëgjimore.

{...}: (Pa mikrofon) Është gjithçka vërtetohet këtu në KLGJ.

Alban Toro: {...}, më ndjek një çik.

{...}: Vërtetohet gjithçka.

Alban Toro: E kuptuam që vërtetohet.

Për ta vërtetuar më shumë, e depoziton tek protokollin dhe i japim fund.

{...}: ...S'ngel asgjë pa u vërtetuar.

Prandaj unë bëra atë kërkim që jua lexova nga shkresa me shkrim.

Pra, nuk kam ç'të sqaroj më tepër. Nuk e kuptoj pse vazhdojnë pyetjet e mëtejshme?! Këtë nuk e kuptoj.

Nuk e kuptoj. Unë bëra një kërkesë. Është e thjeshtë

Ju merrni vendim. Unë po ju pres.

Mbaroi kjo punë.

Naureda Llagami: Nëse nuk kemi ndonjë pyetje tjetër?

Atëherë, zoti {...}, faleminderit që ishit prezent këtu dhe që na dhatë sqarimet e nevojshme mbi kërkesën tuaj.

Këshilli do mblidhet dhe japi një vendim për atë që juve keni kërkuar.

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari {...}.)

(Diskutohet disa minuta nga anëtarët e Këshillit pa u ndezur mikrofonat.)

Atëherë, fjalën po ia kaloj relatores lidhur me shqyrtimin e çështjes konkrete.

Marçela Shehu: Po, zonja Kryetare!

Pas dëgjësës që Këshilli realizoi me gjyqtarin {...}, duke marrë shkas nga ato çka ai parashtrroi sot përpara Këshillit, ku një nga kërkesat e tij ishte edhe dorëheqja nga statusi i magjistratit, vlerësoi, në kushtet kur neni 65 i ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kërkon që ky deklaram, pra dorëheqja nga statusi, të paraqitet në formë të shkruar, t’i japim kohë gjyqtarit të paraqesë një kërkesë të tillë me shkrim përpara Këshillit, e në këtë mënyrë, Këshilli, në mbledhjen tjetër plenare të vlerësojë të dyja kërkesat e paraqitura nga gjyqtari, kërkesën për rikthimin e tij në detyrë dhe kërkesën për dorëheqje nga statusi i magjistratit, në rast se ajo do të paraqitet në formën e kërkuar nga ligji. Ndaj unë vlerësoj që edhe shqyrtimi dhe vendimmarrja e sotshme e Këshillit lidhur me kërkesën për rikthimin në detyrë të gjyqtarit, të shtyhet për mbledhjen tjetër plenare.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Shehu!

Atëherë, jeni dakord me propozimin e bërë nga relatorja?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi ta shtyjë shqyrtimin e projekt-aktit, pasi të merret informacioni i kërkuar zotit/gjyqtarit {...}.

(Anëtarët e Këshillit bëjnë një pauzë prej 10 minutash.)

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor